



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr Prot. Broj Prot. Prot No	05-179
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	29
Data Datum Date	12/01/2017
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Datë	12.01.2017
Numri i referencës	MSH/DSHB/mgj/ 05/01 /2017
PËR/ZA/TO:	Dr. Imet RRAHMANI, Ministër i Shëndetësisë
CC:	Z. Ardian MEHMETAJ, UD, Sekretar i Përgjithshëm i MSh
PËRMESPREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dr. Milazim H. GJOCAJ, Dr. Sci.  Udhëheqës i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport vjetor i punës se DShB për vitin 2016

I nderuar zoti ministër Rrahmani,

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgoj raportin vjetor të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve për vitin 2016 dhe planin e punës për vitin 2017:

Dokumentet e tjera të bashkëlidhura:

1. *Raportin epidemiologjik të përmbledhur*
2. *Raportin mbi disa indikator përshirë drogat dhe duhanin*
3. *PCF, plani i rrjedhës së parasë dhe buxhetin*
4. *Planin e punës se DShB për vitin 2017*

Ju faleminderit për mirëkuptim

Me respekt!

Faqe 1 nga 1



Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Shëndetësisë

Departamenti shëndetësor i burgjeve

**Raporti vjetor punës së Departamentit Shëndetësor të Burgjeve
për vitin 2016**

Përpiluar nga:

Dr. Milazim H. GJOCAJ, Dr.Sci

Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve

Janar, 2017
Në Prishtinë

Përmbajtja e raportit:

HYRJE	3
I. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje	3
1. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së kujdesit shëndetësor	3
2. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mjekësor të burgjeve	4
3. Kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm për të gjithë të burgosurit pa dallim në nivel të njëjtë sikur për qytetaret e tjerë në sistemin publik shëndetësor	4
4. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe kuantitative specifike në burgje si dhe hulumtimi lidhur me disa indikator	5
4. Kujdesi farmaceutik për të gjithë të burgosurit falas sipas LESPK dhe Ligjit për Shëndetësi në Kosovë dhe rregulloret e AKPM-se	5
5. Mbajtja dhe monitorimi i kushteve higjienike sanitare në burgje	6
6. Menaxhimi i mirë i stafit shëndetësor të burgjeve	6
7. Monitorimi i aktiviteteve dhe shërbimeve të cilat përcaktojnë kualitetin e kujdesit shëndetësor	7
II. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve. 14	
Integrimi i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë	14
Buxheti dhe menaxhimi i tij	14
III. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në vend dhe jashtë	14
IV. Monitorimi i cilësisë dhe ankesave të të burgosurve dhe ndërmarrja e masave adekuate 15	
V. Implementimi i Sistemit Informativ Shëndetësor në burgje	16
VI. Përpilimi dhe harmonizimi me BE i protokolleve dhe proceduarve të DShB	16
VII. Vështirësitë dhe mungesat	17
VIII. Synimet	19
IX. SHTOJCAT	19

HYRJE

Qëllimet kryesore të Departamentit Shëndetësor të burgjeve për 2016 janë:

- 1. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje*
- 2. Bashkëpunimi me institucionet e tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve*
- 3. Monitorimi i cilësisë dhe ankesave të të burgosurve dhe ndërmarrja e masave adekuate*
- 4. Implementimi i Sistemit Informativ Shëndetësor në burgje*
- 5. Përpilimi dhe harmonizimi me BE i protokolleve dhe proceduarve të DShB*

Ne vazhdim eshët paraqitur realizimi i planit të punës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2016 sipas qëllimeve dhe planit të punës:

I. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje

1. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së kujdesit shëndetësor

- Në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje janë themeluar dhe janë funksionalizuar në mënyrë të pandërprerë dy komisione; komisioni për monitorim të punës së NjShB dhe Komisioni për shqyrtim të të gjitha ankesave të të burgosurve. Si rezultat i kësaj janë edhe raste evidente, masat dhe propozimet për komisione disiplinore për disa pjesëtar të stafit.
- Janë dërguar informata dhe sqarime për proceduar të ndryshme dhe janë monitoruar respektimit e tyre në dobi të shëndetit të të burgosurve.
- Kemi bashkëpunuar me Avokatin e Popullit dhe mekanizmin për parandalimin e torturës, me KMDLNJ, QKRMT dhe Këshillin e Evropës.
- Po ashtu kemi pasur edhe rishikim dhe diskutim të disa çështjeve me disa Organizata monitoruese. Nga këto organizata kemi kërkuar që ta bëjnë draft projektin për marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëpunim në të kundërtën do të përmbysim bashkëpunimin me to. Monitorimi nga Organizatat jo qeveritare konsiderohet si mjaftë i rëndësishëm dhe partneritet i dobishëm nga ana e jone, por jo profilizimi i tyre dhe monitorimi i “gjithçkafit” pa pasur kompetence dhe raportet e dala nga këto inspektime na ka shkaktuar edhe dëme në vend të dobive. Si do që të jete, disa here këto organizata në mënyrë jo profesionale dhe kompetente kanë tejkaluar mandatin dhe profesionalizimin për të cilin funksionojnë.
- Shërbimet Shëndetësore në burgje janë monitoruar edhe nga Inspektorati Farmaceutik, Inspektorati Sanitar, ai Shëndetësor së fundmi, dhe nga Auditori i përgjithshme.
- Kemi shprehur gatishmëri për bashkëpunim me OJQ të ndryshme në funksion të mbështetjes, monitorimit dhe donacioneve të ndryshme por vetëm përmes marrëveshjeve të qarta dhe profesionale.